



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Tiranë ____/____/2021

Nr. Prot.
Nr. Dok.202003364/4

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e akteve normative dhe atyre individuale për kufizimin e përhapjes së virusit COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në gjykatat në shkallë vendi, me qëllim garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së pandemisë.*

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Tiranë

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR VLORË

Të nderuar,

Pas shpalljes së gjendjes së pandemisë globale Covid-19 në datën 11 Mars 2020 nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, nga ana e strukturave kompetente shtetërore u miratuan një sërë aktesh¹ për marrjen e masave të veçanta administrative në përputhje me situatën, të cilat sollën kufizimin e disa të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese dhe ligjore.

Nuk ka dyshim që pandemia ka prekur shumë nga të drejtat dhe liritë e njeriut që mbrohen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo Karta e të

¹ Akti normativ nr. 3, datë 15.3.2020, i Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", i ndryshuar, VKM nr. 243, datë 24.03.2020, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", nxjerrja e një sërë aktesh normative nga Komiteti Ndërmnistror i Emergjencave Civile si organi më i lartë për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe të burimeve financiare e materiale për përballimin e fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, si dhe nga disa ministra kryesisht Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Drejtave Social Ekonomike dhe që ka ngritur një sërë problemesh të vështira ligjore sipas sa më sipër.

Në nivel të Këshillit të Evropës është hera e parë në historinë e Konventës që shumë prej shteteve anëtare janë prekur në të njëjtën kohë nga e njëjta situatë krize e pazakontë, një situatë e cila prek kaq shumë të drejta të konventës. Pandemia angazhon detyrimet pozitive të shteteve për të mbrojtur jetën dhe shëndetin si dhe të drejta të tjera, ndërkohë që masat e tilla si ndalimi për të dalë nga banesa, të cilat u zbatuan nga qeveritë në përpjekje për të përmbajtur pandeminë dhe për të mbrojtur shëndetin, përbënë ndërhyrje në një sërë të drejtash të parashikuara në konventë. Gjykatat kombëtare dhe vetë Gjykata e Strasburgut do të duhet të mbyllnin dyert dhe të shtynin seancat dëgjimore dhe konsultimet.²

Për këtë arsye, shtetet anëtare duhet të marrin në vëmendje masat e duhura për të reaguar ndaj situatave të shkaktuara nga përhapja e pandemisë, në funksion të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve, por nga ana tjetër pa cenuar në mënyrë joproporcionale qëllimin parësor e të përbashkët të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.³

Sistemi gjyqësor sikurse të gjithë institucionet publike në vendin tonë u përball me sfida të reja të shkaktuara nga pandemia, krahas atyre me të cilat është hasur ky sistem vitet e fundit për arsye të procesit të zbatimit të reformës në drejtësi. Sigurisht, pezullimi i veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, me përjashtim të çështjeve me natyrë të ngutshme, për një periudhë të gjatë 3 mujore solli si pasojë zvarritje të mëtejshme të proceseve gjyqësore, shtyrje të gjykimit të çështjeve të reja, si dhe problematika në respektimin e plotë të të drejtave procedurale gjatë gjykimit.

Pavarësisht kësaj gjendjeje, Institucioni i Avokatit të Popullit në vijimësi ka kryer detyrën në përmbushje të misionit të tij kushtetues, për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë si edhe evidentimin e rasteve të ndryshme të mosrespektimit apo mosgarantimit të të drejtave themelore të njeriut, në atë masë që janë të pakufizueshme apo të pakufizuara nga aktet normative të nxjerrë për këtë qëllim.

Në këtë kuadër, nga ana jonë është ndjekur me vëmendje rasti i bërë publik në media në datë 16.12.2020, në të cilin trajtohet problematika e vërejtur gjatë zhvillimit të seancës së rivlerësimit të masës së sigurisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për 41 shtetas të ndaluar në lidhje me aksionin anti-kanabis të ndërmarrë nga prokuroria dhe policia në qytetin bregdetar.⁴

Ndër të tjera në artikull, ngrihet shqetësimi se një prej të arrestuarve që ishte në sallë ka shfaqur simptomat e Covid-19. Nga pala mbrojtëse është kërkuar që personi në fjalë të mos jetë prezent. Ndërkohë gjyqtarja nuk e ka marrë parasysh kërkesën, ka vijuar seancën edhe pse në sallë kanë qenë mbi 40 persona të pandehur dhe punonjës të policisë.

² Guida “Covid-19 dhe Impakti mbi të Drejtat e Njeriut”, shikim i përgjithshëm mbi jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botim i AIRE Centre dhe Civil Rights Defenders, Shtator 2020.

³ Po aty ... Guida “Covid-19 dhe Impakti mbi të Drejtat e Njeriut”.

⁴ Për më tepër, mund të shihet:

<https://www.facebook.com/1598062646883939/posts/skandaloze-i-arrestuari-n%C3%AB-vlor%C3%AB-shfaq-shenjat-e-covidit-gjyqtarja-indiferente-v/3714657018557814/>

Për sa më sipër, kjo çështje ka qenë në vëmendjen e Avokatit të Popullit i cili nisi me iniciativë verifikimin e kësaj çështje.

Në kuadër të një hetimi të pavarur administrativ, u kërkua informacion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë nëse janë respektuar në rastin konkret masat kufizuese për përhapjen e Covid-19 gjatë seancave të zhvilluara në përputhje me parashikimet e udhëzimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.146, datë 27.04.2020 *“Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në gjykata”*.

Konkretisht, për të marrë të dhëna më të plota iu parashtruan këtij organi disa pyetje si më poshtë vijon:

- Sa persona kanë qenë të pranishëm në sallë atë ditë duke përfshirë të arrestuarit, punonjësit e policisë dhe përfaqësuesit e mediave si dhe stafin e gjykatës?
- A ka pasur pretendime gjatë zhvillimit të seancës nga personat e arrestuar që paraqisnin shenja sëmundjeje?
- A janë miratuar nga Këshilli i Gjykatës masa organizative për zhvillimin e veprimtarisë gjyqësore ashtu dhe shërbimeve administrative të gjykatës gjatë kohëzgjatjes së epidemisë?

Me shkresën Nr.40 Prot., datë 12.01.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë është përgjigjur pjesërisht mbi pyetjet e ngritura nga institucioni i Avokatit të Popullit.

Nga ana e tyre është dërguar informacion se:

“Në datën 15.12.2020 nga ana e prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë është depozituar kërkesa penale me objekt: Marrje në pyetje e personave të arrestuar. Kjo kërkesë i ka kaluar për gjykim gjyqtarës E.M, si gjyqtare e hetimeve paraprake dhe është caktuar si datë për shqyrtimin e kërkesës data 16.12.2020 ora 09.30.

Aktualisht dosja përkatëse mbahet nga gjyqtarja e çështjes për shkak se ka akoma persona ndaj të cilëve nuk janë ekzekutuar masat e sigurimit dhe rrjedhimisht nuk është bërë verifikimi i tyre.

Gjykimi është zhvilluar në sallën më të përshtatshme që ka Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me ndriçim dhe ajrosje në të cilën mund të akomodohen në kushte normale (ulur në stola) rreth 50 persona përveç trupit gjykues.

Sipas informacionit të marrë nga gjyqtarja e çështjes rezulton se në seancën gjyqësore të datës 16.12.2020, gjyqtarja e çështjes ka operuar me verifikimin e zbatimit të masës së sigurimit ndaj personave nën hetim gjithsej 32 persona duke i ndarë ata në grupe, në grupin e parë, të dytë dhe të tretë, me nga 10-12 të arrestuar dhe 5-6 avokatë prezentë, për efekt të masave që duhen marrë në kuadër të gjendjes së pandemisë për efekt të parandalimit të situatës, përhapjes së infeksioneve.

Vetëm shpallja e vendimit është bërë në prani të të gjithë të arrestuarve.

Numri i punonjësve të policisë në sallën e gjykimit ka qenë i kufizuar, pasi pjesa tjetër ka qenë jashtë sallës së gjykimit në korridorin e brendshëm dhe të jashtëm të gjykatës.

Është pretenduar nga dy prej avokatëve prezent në sallë se njëri prej personave të arrestuar ka qenë i infektuar me Covid-19, por nuk është bërë shoqërimi i tij për në sallën e gjyqit, pasi ishte e dokumentuar nga mjeku se ka qenë i infektuar dhe për këtë të arrestuar është proceduar vetëm më praninë e avokatit.

Ndërkohë nga gjyqtarja e çështjes është pyetur në seancë shefi i rendit nëse ka prezent në sallë persona të infektuar me Covid-19 dhe shefi i rendit është përgjigjur se:

“Nuk kam informacion individual për personat e ndaluar, të gjithë personave u janë vënë në dispozicion mjeku dhe ambulancat. Për një person kemi marrë masa të veçanta në banesë, mund të ketë, por nuk jemi të informuar.”

Nga informacioni i marrë, gjyqtarja ka deklaruar se ka pasur në dispozicion vetëm një ditë për të realizuar seancën për verifikimin e masës së sigurimit, “arrest në burg” dhe “arrest në shtëpi”, pasi kërkesa e prokurorit ka ardhur pas 48 orëve në gjykatë, nga momenti që është realizuar ekzekutimi i masës së sigurimit të vendosur me vendimin e datës 13.12.2020.

Në bazë të nenit 248 të Kodit të Procedurës Penale “Marrja në pyetje e personit të arrestuar”, jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i masës, gjykata e merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur arrestin në burg ose në shtëpi.

Nga ana e organit të akuzës kjo çështje është një procedim i vetëm dhe si i tillë gjykata në zbatim të parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale është e detyruar të procedojë në një gjykim të vetëm.

Përsa i përket pyetjes së parashtruar nga ana jonë në lidhje me masat organizative për zhvillimin e veprimtarisë gjyqësore, ashtu edhe shërbimeve administrative të gjykatës gjatë kohëzgjatjes së epidemisë, organi i gjykatës na ka informuar se Këshilli i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka marrë Vendim nr.2, datë 10.03.2020 “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në zbatim të vendimit nr.127, datë 10.03.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor Tiranë; Vendim nr.3, datë 30.04.2020 të Këshillit të Gjykatës Vlorë për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; Vendim nr.4, datë 01.06.2020 bazuar në Aktin Normativ nr.21 datë 27.05.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr.98, datë 29.05.2020 “Për disa ndryshime në Aktin Normativ nr.9, datë 25.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohës së zgjatjes së gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga Covid-19” miratuar me ligjin nr.30/2020.”

Për sa është paraqitur në kthimin e përgjigjes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nuk u është dhënë përgjigje konkretisht pyetjeve të shtruara nga ana jonë, pra nëse janë respektuar gjatë procesit gjyqësor masat kufizuese për përhapjen e Covid-19 gjatë seancave të zhvilluara në përputhje me parashikimet e udhëzimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.146, datë 27.04.2020 “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në gjykata”, si dhe sa persona kanë qenë në total të pranishëm në sallë gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore në datë 16.12.2020, duke përfshirë të arrestuarit, punonjësit e policisë, punonjësit e mediave si dhe stafin e gjykatës.

Nga ana tjetër, rezulton se Këshilli i Gjykatës së Rrethit Vlorë ka miratuar aktet e nevojshme, si dhe rregulloren “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”.

Sigurisht, që nga ana jonë vlerësohet miratimi i akteve të domosdoshme për të normuar dhe njëkohësisht përcaktuar masat kufizuese të përhapjes së pandemisë covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë në gjykatat e vendit.

Por, pa dyshim që nuk është e mjaftueshme që këto akte të mbeten vetëm të shkruara, ato gjithashtu duhet të vihen në zbatim me qëllim implementimin e tyre gjatë realizimit të seancave gjyqësore, për të garantuar në këtë mënyrë qëllimin e masave kufizuese, pra parandalimin e përhapjes së virusit.

Në një mori kronikash mediatike të datës 16.12.2020 kanë qarkulluar pamjet filmike të seancës gjyqësore të zhvilluar mbi vlerësimin e masave dhe me të drejtë është ngritur shqetësimi i arsyeshëm se në sallë kanë qenë të pranishëm një numër i konsiderueshëm shtetasish (mbi 40 persona, të pandehur, avokatët e tyre, punonjës të policisë, përfaqësues të medias), duke mos u respektuar aspak distancimi social.

Po nga pamjet filmike, vërehet qartë se është një numër i konsiderueshëm punonjësish të policisë të pranishëm në sallë, numër i cili nuk është evidentuar në përgjigjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.⁵

Rregullat e përgjithshme që zbatohen në rastet e transferimit dhe lëvizjeve të personave të arrestuar/ndaluar, janë si më poshtë: a) Përlllogaritja dhe raporti i numrit të punonjësve të policisë për çdo të arrestuar/ndaluar të jetë, jo më pak se dy punonjës policie. b) Kur janë më shumë se tre të arrestuar/ndaluar, numri i punonjësve të policisë, caktohet me urdhër të Drejtorit/shefit të komisarariatit të policisë. Në këtë rast gjithmonë numri i punonjësve të policisë minimalisht duhet të jetë një më shumë se numri i të arrestuarve dhe ndaluarve. 2.2 Shoqërimi i të arrestuarve/ndaluarve në çdo rast bëhet vetëm gjatë ditës (pas lindjes së diellit dhe para perëndimit të tij). Në raste të defekteve të automjeteve, avarive dhe të papriturave të tjera, vendosja dhe sigurimi tyre bëhet përkohësisht në komisariatin e policisë më të afërt. Në këtë rast vihet në dijeni menjëherë Shërbimi Sallës Komandimit, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit. 2.3 Lëvizja e shoqërimi bëhet duke i mbajtur të prangosur, me duar para, ose kur janë dy persona mund të lidhen me pranga dorë në dorë me njeri-tjetrin. 2.4 Patrulla e policisë së shërbimit të jetë e pajisur me armatim personal (pistolete, automatik e municionin përkatës), jelekë antiplumb, aparat telefonik të komunikimit brenda Policisë së Shtetit dhe radiondërlidhje me të gjitha kanalet e komisariateve ku do të kalojnë.

⁵ Bazuar në Procedurën Standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me urdhër nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. “Rregullat e përgjithshme që zbatohen në rastet e transferimit dhe lëvizjeve të personave të arrestuar/ndaluar, janë si më poshtë:

a) Përlllogaritja dhe raporti i numrit të punonjësve të policisë për çdo të arrestuar/ndaluar të jetë, jo më pak se dy punonjës policie.

b) Kur janë më shumë se tre të arrestuar/ndaluar, numri i punonjësve të policisë, caktohet me urdhër të Drejtorit/shefit të komisarariatit të policisë. Në këtë rast gjithmonë numri i punonjësve të policisë minimalisht duhet të jetë një më shumë se numri i të arrestuarve dhe ndaluarve.”

Në rastin e ndarjes me nga 10-12 persona të arrestuar, duke shtuar këtu edhe numrin e punonjësve të policisë që i shoqërojnë, nuk zbatohen masat e marra për parandalimin e pandemisë.

Ndërkohë, trupi gjykues ka vijuar seancën edhe pse salla, qartazi ka qenë e tejmbushur me të pranishëm në një situatë pandemie.

Akti Normativ nr.9, datë 25.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19”, ndryshuar më pas me Aktin Normativ nr.21, datë 27.05.2020 ka pasur si qëllim garantimin e të drejtës për një proces të rregullt në veprimtarinë gjyqësore dhe atë të prokurorisë, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga përhapja e COVID-19, duke parashikuar rregulla të qarta për hapat që do të ndiqen.

Në të, përcaktohet se gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, gjykatat zhvillojnë seancat gjyqësore në çështjet administrative, civile dhe penale, duke zbatuar masat organizative specifike për zhvillimin e proceseve gjyqësore, të nevojshme për të shmangur grumbullimet në ambientet e gjykatave dhe brenda sallave gjyqësore, sipas rregullave që miratohen në përputhje me parashikimet.

Kështu, më konkretisht në Aktin Normativ nr.9, datë 25.03.2020 përcaktohet: “Gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga përhapja e COVID-19 dhe me synimin për të kufizuar efektet negative në veprimtarinë gjyqësore, këshillat si dhe organet e administrimit gjyqësor të çdo gjykate, sipas kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj dhe në funksion të zbatimit të rregullave nënligjore të nxjerra nga organet përgjegjëse, miratojnë masa organizative specifike për zhvillimin e proceseve gjyqësore, të nevojshme për të shmangur grumbullimet në ambientet e gjykatave dhe brenda sallave gjyqësore, si dhe kontaktet e ngushta ndërmjet individëve, që kanë të bëjnë me:

- a) kufizimin e hyrjes së publikut në ambientet e gjykatës, duke garantuar, kundrejt rregullave të vendosura për këtë qëllim, vetëm aksesin e individëve që duhet të kryejnë veprimtari që kanë urgjencë;
- b) rregullimin e aksesit në shërbime, me rezervim, edhe nëpërmjet komunikimit telefonik ose elektronik, duke u kujdesur që përdoruesit të mund të përdorin shërbimet brenda një kohe të caktuar, si dhe miratimin e çdo mase që konsiderohet e nevojshme për të shmangur grumbullimet;
- c) vendosjen e udhëzuesve detyrues për kufizimin dhe mënyrën e lëvizjes së personave. Udhëzuesit publikohen në faqen e internetit të gjykatës dhe Këshillave;
- ç) zhvillimin me dyer të mbyllura të të gjitha seancave gjyqësore publike për çështjet e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, në zbatim të pikës 2, të nenit 20, të ligjit nr.49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të nenit 173, të Kodit të Procedurës Civile, ose të nenit 340, të Kodit të Procedurës Penale;
- d) kryerjen e seancave mbi bazë dokumentesh në çështjet administrative dhe civile, të parashikuara në pikën 3, të këtij neni, në të cilat nuk kërkohet prania e palëve, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të komunikimit elektronik për paraqitjen e akteve procedurale dhe dhënien e vendimit nga gjykata.”

Ndërsa në nenin 4 të Aktit Normativ nr.21, datë 27.05.2020 parashikohet se:

“Pjesëmarrja e palëve, ndërhyrësit kryesor, ndërhyrësit dytësor, personit të tretë ose përfaqësuesve të tyre, prokurorit, të pandehurit, të paraburgosurit, avokatit mbrojtës, vitkimës,

vitkimës akuzuese, paditësit, të paditurit civil, avokatit të shtetit, dëshmitarëve, ekspertëve, përkthyesve si dhe çdo pjesëmarrësi tjetër të përfshirë ose të interesuar, në të gjitha seancat përgatitore/gjyqësore sigurohet atje ku është e mundur dhe vetëm pasi palët kanë dhënë pëlqimin brenda një afati të caktuar nga gjykata, nëpërmjet ndërlidhjes audiovizive në distancë, duke përdorur programe kompjuterike të përshtatshme për këtë qëllim.

Mënyra e ndërlidhjes në distancë duhet të sigurojë, në çdo rast, shikueshmërinë e ndërsjellë të personave të pranishëm në të dyja vendet e ndërlidhura dhe mundësinë e dëgjimit nga të gjitha palët. Nëse parashikohet pjesëmarrja e disa palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces, secili prej tyre duhet të vendoset në kushte që të mund të shikojë dhe të dëgjojë të tjerët.”

Nëpërmjet udhëzimit nr. 146, datë 27.04.2020 “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në gjykata”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pasur si objekt përcaktimin e rregullave orientuese në lidhje me masat organizative dhe administrative që duhet të merren nga të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore me qëllim parandalimin e përhapjes së Covid-19. Rregullat e parashikuara në këtë udhëzim nuk cenojnë, por janë pjesë dhe kanë për qëllim garantimin e një procesi të rregullt dhe ligjor gjatë kohëzgjatjes së epidemisë.

Në udhëzim përcaktohet shprehimisht:

“Këshillat e Gjykatave si dhe organet e administrimit gjyqësor, sipas kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj dhe në funksion të zbatimit të rregullimeve ligjore dhe akteve të nxjerra nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, të miratojnë masa organizative për zhvillimin e veprimtarisë gjyqësore ashtu dhe shërbimeve administrative të gjykatës gjatë kohëzgjatjes së epidemisë. Masat duhet të garantojnë organizimin dhe zhvillimin e proceseve si dhe shërbimeve gjyqësore, duke shmangur grumbullimet si në ambientet e gjykatave ashtu dhe brenda sallave gjyqësore.

Rregullat që duhet të miratojnë gjykatat duhet të orientohen drejt:

- (i) garantimit të vijimësisë normale si të veprimtarisë ashtu dhe të shërbimeve gjyqësore në gjykatë;
- (ii) reduktimit të transmetimit të infeksionit midis punonjësve apo dhe përdoruesve të gjykatës;
- (iii) sigurimit të një ambienti të shëndetshëm në gjykatë.

Gjithashtu, Këshillat e Gjykatave si dhe organet e administrimit gjyqësor, të miratojnë masa për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive gjyqësore, duke u fokusuar ndër të tjera, në:

1. Rritjen e bashkëpunimit me Institucionin e Prokurorisë, Dhomën e Avokatisë, Drejtoritë/Komisariatet e Policisë, Institutin e Mjekësisë Ligjore, Shërbimin e Provës, Zyrat e Shërbimit Social, ekspertët, përkthyesit etj., me qëllim koordinimin mes tyre të planifikimit të seancave gjyqësore, për të mundësuar komunikimin në distancë me gjykatën nëpërmjet postës elektronike dhe/ose telefonit/faksit;
2. Nxitjen e përdorimit të komunikimeve elektronike si një mjet efikas në kushtet kur distancimi social është shumë jetik në kufizimin e përhapjes së virusit, duke zvogëluar në minimum përdorimin e komunikimit shkresor;
3. Planifikimin, në bashkëpunim me gjyqtarët, të orareve të ndryshme në thirrjen e dëshmitarëve dhe/ose ekspertëve, duke kufizuar, për aq sa është e mundur, thirrjen për të dëshmuar të një numri të madh dëshmitarësh brenda të njëjtës seancë. Ballafaqimi mes dëshmitarëve të bëhet në distancë mes tyre, në respektim të masave kufizuese.

4. Komunikimin me institucione të tjera, në të cilat lind nevoja për të kryer verifikime në vend, duke kërkuar prej tyre krijimin e mundësisë që trupa gjyqësore, sekretari seancës si dhe palët pjesëmarrëse, të priten nga një punonjës, në një ambient më vete që plotëson kushtet higjieno-sanitare dhe ato të distancimit social, pa prezencë të punonjësve të tjerë të institucionit;
5. Në njoftimin e menjëhershëm të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim, në rastet e ekzistencës së shkaqeve objektive që pamundësojnë zhvillimin e një seancë të planifikuar (për të cilat gjykata vihet në dijeni para zhvillimit të seancës);
6. Zbatimin në mënyrë fleksible të kohës ashtu dhe të vendeve të punës, si p.sh. në hartimin e një kalendari lidhur me përdorimin e sallave të gjykimit, të ndërrimit të orarit të punës/ditëve të punës, apo dhe mundësimin e punës dhe të komunikimeve të distancë (p.sh. telefon, video ose Ëëb);

Këto rregulla parashikohen edhe në rregulloren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”, me qëllim kufizimin e përhapjes së Covid-19, gjatë vijimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore të kësaj gjykate, duke reduktuar transmetimin e infeksionit midis punonjësve të gjykatës, sigurimin e një ambienti të shëndetshëm në punë dhe vijimësinë normale të aktivitetit të gjykatës.

Nga informacioni i sjellë në formë shkresore, por edhe nga pamjet e publikuara në media, evidentojmë se gjatë realizimit të seancës gjyqësore të datës 16.12.2020 nuk është respektuar distancimi prej 2 m.

Edhe pse parashikohet në rregullore se seancat gjyqësore me të dënuar apo të arrestuar me masë sigurimi “arrest në burg” për çështjet urgjente, sipas nenit 259 pika 1 dhe 2 e Kodit të Procedurës Penale, do të zhvillohen nëpërmjet ndërlidhjes audiovizive në distancë dhe në rast se ata kanë dhënë pëlqimin që këto seanca të bëhen në mungesë të tyre, vazhdimin e gjykimit me pjesëmarrjen e mbrojtësit të zgjedhur prej tyre, konstatohet se kjo mundësi nuk është marrë parasysh nga trupi gjykues në rastin konkret. Lidhur me zbatimin e këtij parashikimi të rregullores, gjykata nuk është shprehur në përgjigjen e saj.

Seancat gjyqësore civile dhe penale mund të zhvillohen dhe në distancë sipas parashikimeve të nenit 4 të Aktit Normativ nr.21, datë 27.05.2020 “Për disa ndryshime në aktin normative nr.9, datë 25.03.2020 të Këshillit të Ministrave “për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohës së zgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid 19” miratuar me ligjin nr.30/2020, por konstatojmë se kjo nuk ka gjetur zbatim gjatë këtij procesi penal.

Avokati i Popullit është i vetëdijshëm se pandemia Covid-19 ka krijuar sfida të jashtëzakonshme për të gjithë autoritetet shtetërore dhe gjyqësore.

Por gjatë punës së tyre, një nga parimet themelore duhet të jetë ndërmarrja e të gjitha veprimeve të mundshme për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e të gjithë personave të privuar nga liria. Ndërmarrja e këtyre veprimeve gjithashtu kontribuon në ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë së stafit të institucioneve.

Vlerësojmë se, është thelbësore të respektohen dhe zbatohen plotësisht nga gjykatat në shkallë vendi udhëzimet e OBSH-së për luftimin e pandemisë gjithashtu ato të shëndetit kombëtar dhe udhëzimet klinike në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Situata e fatkeqësisë natyrore, kur garantimi i shëndetit të qytetarëve merr përparësi, e bën të pamundur funksionimin normal të shtetit të së drejtës si dhe imponon kufizimin e një sërë të drejtash të individit. Por ndërsa luftimi i pandemisë kërkon masa radikale dhe ndërhyrje shtetërore për të siguruar bindjen ndaj kufizimeve, këto masa nuk nënkuptojnë sakrifikim të plotë të kontrolleve dhe ekuilibrave demokratikë. Është e rëndësishme që edhe në një periudhë të tillë emergjence, garancitë në dispozicion të qytetarëve të mos cenohen përtej detyrimeve Kushtetuese si dhe në proporcion me situatën.

Tashmë që faza e parë e përballimit të pandemisë ka kaluar është me vlerë që të kryhet një analizë e funksionimit të shtetit të së drejtës dhe proporcionalitetit të masave të ndërmarra gjatë kësaj periudhe të gjendjes së jashtëzakonshme.

Parimi i shtetit të së drejtës është një nga elementët themelorë të demokracisë si formë e qeverisjes. Garantimi përmes normave kushtetuese dhe akteve të tjera ligjore si dhe zbatimi i këtij parimi në jetën e përditshme, janë kushte të domosdoshme për funksionimin dhe zhvillimin e një shoqërie të lirë dhe respektimin sa më mirë të të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Autoritetet duhet të sigurojnë që veprime të tilla të kryhen duke respektuar normat demokratike: zbatimin e shtetit të së drejtës, transparencën dhe përgjegjshmërinë. Pandemia nuk mund të justifikojë pezullim të palimituar të demokracisë, ndërsa kufizimet e lirive civile duhet të jenë të përkohshme, proporcionale dhe transparente.

Transmetimi në media i pamjeve filmike, ku evidentohet shkelja e masave të marra për mospërhapjen e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, i çon qytetarët në uljen e besimit të sistemi gjyqësor, si dhe në mosrespektimin e rregullave, kur këto të fundit shkelen nga vetë gjykatat.

Ndërkohë, referuar të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, situatës së përhapjes së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, në muajin dhjetor 2020 numri i të infektuarve dhe humbjeve të jetës ka qenë relativisht i lartë⁶ (2657 testime, 505 të shëruar, 637 raste të reja dhe 12 humbje jete).

Kushtetuta ka të përcaktuar qartë se cilat janë të drejtat dhe liritë që mund të kufizohen, privohen apo derogohen. E drejta për një proces të rregullt ligjor referuar Kushtetës dhe me konkretisht nenit 175 paragrafi dytë, nuk identifikohet si një nga të drejtat që mund të kufizohet. Kjo e drejtë ashtu si të drejtat e tjera vetjake nuk është abstrakte apo deklarative, që konfirmon shtetin e së drejtës. Ajo konkretizohet dhe përmbushet nëpërmjet punës dhe veprimtarisë së gjykatave. Pa funksionimin e gjykatave nuk kemi proces dhe për pasojë, nuk mundet as të pretendojmë që të kemi një proces të rregullt ligjor.

Në nenin 17 të Kushtetutës, përcaktohet se *“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë ...nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”*

Sidoqoftë, parimi më i rëndësishëm që nuk duhet anashkaluar në gjithë këtë proces të vështirë është ruajtja e balancës mes nevojës për veprim dhe masave për t’iu përgjigjur kësaj nevoje. Pra,

⁶<https://shendetesia.gov.al/covid19-ministria-e-shendetesise-2657-testime-505-te-sheruar-637-raste-te-reja-dhe-12-humbje-jete-ne-24-oret-e-fundit/>

në emergjencën e veprimeve që kërkon situata nuk duhet humbur nga vëmendja proporcionaliteti i masave të marra.

Kur seancat mbahen në distancë, kriteret e nenit 6 të KEDNJ-së vazhdojnë të aplikohen. Kjo përfshin të drejtën e të akuzuarit ose paditësit për të marrë pjesë në mënyrë efektive në një seancë dëgjimore ose gjyq⁷, çka do të thotë jo vetëm e drejta për të qenë i pranishëm por edhe për të dëgjuar dhe ndjekur procedurat. Zërimi i dobët dhe vështirësitë e të dëgjuarit në sallën e gjyqit mund të ngrenë çështje sipas Nenit 6⁸, dhe kjo aplikohet edhe në kontekstin e seancave në distancë gjithashtu. Gjykata e Strasburgut e ka pranuar që marrja në pyetje përmes videolidhjes mund të sigurojë pjesëmarrjen efektive në procedura⁹ dhe ka gjetur që përdorimi i videokonferencave nuk është as problem e as avantazh sipas Nenit 6, për sa kohë që shfrytëzimi i tyre i shërben arritjes së qëllimit të garantimit të drejtësisë së tërësishme të procedurave.

Ashtu si me të drejtë është konstatuar edhe nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit¹⁰, kuadri ynë ligjor procedural që rregullon veprimtarinë e gjykatave rezulton të ketë mangësi sa i takon dispozitave që do duhet të rregullonin vijueshmërinë e punës së gjykatave online, duke mundësuar këtu përdorimin e videokonferencës për zhvillimin e seancave gjyqësore, në kushtet e kësaj pandemie globale të paprecedentë jo vetëm për vendin tonë, por për mbarë botën.

Pavarësisht dobishmërisë së Aktit normativ me fuqinë e ligjit të Këshillit të Ministrave, nr. 9, dt. 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19” dhe ndryshimeve të mëpasshme të tij, vërehet se miratimi i aktit nuk u harmonizua reciprokisht në kohë me veprimtarinë e KLGJ-së për rifillimin e punës së pezulluar në gjykata si dhe me dispozitat e legjislationit procedural (civil, penal dhe administrativ).

Teksa KLGJ vendosi të rifillojë veprimtarinë dhe shërbimet gjyqësore në gjykata në datë 27.04.2020, akti normativ i sipërpërmendur i hapi rrugë rifillimit të punës në gjykata në datë 27.05.2020. Në aktin normativ të ndryshuar, parashikohet që seancat gjyqësore do të zhvillohen me dyer të mbyllura, ndërkohë që diskrecioni për këtë, sipas Kodit të Procedurës Civile dhe atij Penal është atribut eskuziv që rast pas rasti i përket trupit gjykues, bazuar në rrethanat e parashikuara në dispozitat përkatëse të këtyre dy Kodeve. Përdorimi i sistemit audio-vizual për realizimin e proceseve gjyqësore respektive është i limituar për tu përdorur nga gjykata sipas këtyre Kodeve, vetëm në raste dhe rrethana specifike që nuk përgjithësojnë përdorimin e tyre në çdo rast, në kushtet e pandemisë.

Perceptimi i publikut është se aksesimi në drejtësi, si pjesë substanciale e procesit të rregullt gjyqësor, rezulton të jetë afektuar në një shkallë tepër të lartë, për shkak të pandemisë globale Covid – 19.

Ndaj është e nevojshme të publikohen të dhëna lidhur me mënyrën e funksionimit të platformës audiovizuale të përdorur nga gjykatat, gjatë periudhës së epidemisë, si dhe të merren masat e nevojshme që gjykatat të jenë të pajisura me kushtet e nevojshme logjistike dhe teknologjike për realizimin e video-konferencave.

⁷ Murtazaliyeva k. Ruisë, gjykim i Dhomës së Madhe i 18 dhjetorit 2018, 36658/05,

⁸ Stanford k. Mbretërisë së Bashkuar, gjykim i 23 shkurtit 1994, Nr.16757/90, § 29.

⁹ Stanford k. Mbretërisë së Bashkuar, gjykim i 23 shkurtit 1994, Nr.16757/90, §§ 138-139, §§ 144-145; Bivolaru k. Rumanisë, gjykim i 2 tetorit 2018, Nr. 66580/12

¹⁰ Raport i pjesshëm mbi veprimtarinë e gjyqësorit dhe disa organeve të qeverisjes të drejtësisë në kushtet e pandemisë Covid-19

Për gjithë sa parashtruam, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike”, si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për avokatin e Popullit”, i ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”:

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave të nevojshme për respektimin me rigorozitet të akteve normative dhe atyre individuale për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në gjykatat në shkallë vendi, me qëllim garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së pandemisë të shkaktuar nga përhapja e COVID-19.
- Marrjen e masave për përgjithësimin e këtij rasti, objekt i hetimit administrativ, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me qëllim mospërsëritjen e një situatë të tillë në të ardhmen.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar lutemi na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA